




QASJE NË DOKUMENTE ZYRTARE VETËM PËR ZYRTARËT

Një analizë e shkurtër e sfidave të zbatimit të së drejtës për qasje në informacion zyrtar në 7 Komuna të Kosovës

A photograph of a woman with long blonde hair, wearing a light-colored jacket, holding a white banner. The banner has a cartoon character of a person with glasses and a red hand. The text on the banner is partially visible, showing "PULA sa të doni" and "veç a keni".

PULA sa të doni
veç a keni

Lëvizja FOL

Ky raport është publikuar nga Lëvizja FOL në kuadër të projektit "FOL për qasje në dokumente zyrtare" i cili mbështetet nga Balkan Trust for Democracy (BTD).



Një analizë e shkurtër e sfidave të zbatimit të së drejtës për qasje në informacion zyrtar në 7 Komuna të Kosovës

“Qasje në dokumente zyrtare vetëm për zyrtarët”

Mars, 2010

Ky raport është publikuar nga Lëvizja FOL në kuadër të projektit “FOL për qasje në dokumente zyrtare” i cili mbështetet nga Balkan Trust for Democracy (BTD).

Lëvizja FOL
Rruga “UCK” 46/5, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Mob: +377(0) 44 131 542
Ueb: www.levizjafol.org
E-mail: info@levizjafol.org

Për Lëvizjen FOL

FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetarë në vendimmarrje për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL, punon për të përmirësuar dhe arritur nivel më të mirë të përfaqësimit të qytetarëve dhe interesave të tyre në institucionet vendimmarrëse. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parime demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje.

Shpenzimi i fondeve publike, konfliktit i interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale si dhe qasje në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare ndaj vendimmarrjes si dhe të bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

FOL nëpërmjet hulumtimit, mobilizimit dhe rrjetëzimit, do të realizojë aktivitete që do të rrisin presion publik në proceset vendimmarrëse, politike, ekonomike e sociale për të shtyrë përpara alternativa dhe mundësi më të mira të zgjidhjes së problemeve të qytetarëve.

FOL nënkupton një thirrje për kritikë dhe opozitë konstruktive kundrejt politikave jofunkionale, abuzimit me pushtetin dhe fuqinë politike. FOL, kërkon nga qytetarët, tanimë të një shteti të pavarur që të reagojnë për të mbrojtur vetë shtetin për të cilin u sakrifikuan dhe punuan.

FOL ofron dhe mbështet individët dhe organizatat që punojnë për të përparuar përpjekjet në zhvillimin dhe ndërtimin e shoqërisë së hapur dhe demokratike. Ne do të realizojmë dhe mbështesim veprime jo të dhunshme dhe konstruktive për të kundërshtuar veprime që kërcënojnë dhe degradojnë të drejtat e individit, grupeve, etnive dhe komuniteteve pa dallim feje dhe përkatësie nacionale.

Falënderime

Publikimi i këtij raporti u mundësua nga mbështetja e Balkan Trust for Democracy (BTD). Qëndrimet në këtë raport nuk përfaqësojnë qëndrimet e BTD-së. Ky raport është rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar si nga stafi i Lëvizjes FOL por edhe nga bashkëpunëtorët jashtë lëvizjes. FOL falënderon personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti.

Metodologjia:

Lëvizja FOL përmes bashkëpunëtorëve të saj në Komunitat: Vushtrri, Podujevë, Klinë, Kamenicë, Mitrovicë, Malishevë dhe Lipjan ka realizuar pyetësor me zyrtarët komunal për të kuptuar zbatimin e ligjit për qasje në dokumente zyrtare. Pyetësi ka përmbajtur pyetje për kërkesat e qytetarëve për qasje në dokumente zyrtare, numri i refuzuar dhe numri i pranuar i kërkesave.

Përqendrimi i OJQ-ve vetëm në qytetet e mëdha dhe mungesa e pranisë së tyre në disa komuna më të vogla ka qenë edhe arsyeja që Lëvizja FOL ka përzgjedhur këto komuna duke shtrirë aktivitetin e saj edhe jashtë Prishtinës.

Në këtë raport do të pasqyrohen në detaje përgjigjet e zyrtarëve komunal të këtyre shtatë komunave të Kosovës në pyetjet e përgatitura nga Lëvizja FOL. Pyetjet që i janë bërë zyrtarëve komunal nga bashkëpunëtorët e Lëvizjes FOL kanë qenë të njëjta për të gjitha komunitat, ku përveç numrit të kërkesave për qasje në dokumente zyrtare ka pasur edhe pyetje që kanë të bëjnë në përgjithësi me obligimet e komunave të dala nga Ligji për Qasje në Dokumente Zyrtare.

Hyrje

Transparenca dhe llogaridhënia janë veprimet thelbësore për qeverisje të mirë, funksionale dhe të përgjegjshme. Qeverisja e mirë lokale nuk ka të bëjë vetëm me ofrimin e shërbimeve publike, por edhe me krijimin e hapësirës për pjesëmarrje demokratike qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Kjo analizë e shkurtër trajton zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare në komunitat: Vushtrri, Podujevë, Klinë, Kamenicë, Mitrovicë, Malishevë dhe Lipjan. Ligji për Qasje në Dokumente Zyrtare 2003/12 është nxjerr në vitin 2003 me qëllim që qytetarëve të Kosovës t'u mundësohet që më për së afërmi të marrin pjesë në procesin vendimmarrës të institucioneve publike dhe të garantohet që institucionet publike të gëzojnë legjitimitet dhe transparencë më të madhe, të jenë më efikase dhe t'i japin më shumë llogari qytetarëve të Kosovës.

Komunitat e Kosovës duhet të kenë për qëllim forcimin e transparencës së organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative komunale, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivelin lokal dhe lehtësimin e qasjes së publikut mbi dokumentet zyrtarë të komunave¹.

¹ Udhëzim administrativ Nr. 2006/03 "Për transparencën në Komuna"

Lëvizja FOL ka marrë përgjigje nga disa komuna të Kosovës lidhur me implementimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare gjatë vitit 2009. Ky raport nuk përmban kërkesa të dërguara nga Lëvizja FOL këtyre Komunave, por janë të dhëna zyrtare të cilat bashkëpunëtorët e FOL-it i kanë marrë nga zyrtar të këtyre komunave, andaj ky raport mëton të ofron një pasqyrë të implementimit të ligjit dhe akteve nën-ligjore në nivel komunal.

Legjislacioni që garanton qasjen në dokumente zyrtare

Kushtetuta e Republikës së Kosovës:

Qasja në dokumente zyrtare na garantohet edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Neni 41 i saj thotë: “Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë”.

Ligji për Qasje në Dokumente Zyrtare nr.2003/12

Ligji për Qasje në Dokumente Zyrtare është miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 16 tetor 2003. Ky Ligj që nga miratimi i tij është cilësuar me mangësi tejet të mëdha, mirëpo këto mangësi nuk e arsyetojnë mos zbatimin e tij në praktikë.

Gazetarët janë ata të cilët moszbatimi i këtij ligji i ka vështirësuar punën e tyre, ngase institucionet e ndryshme nuk ju kanë ofruar qasje në dokumente zyrtare.

Zbatimi i ligjit për qasje në dokumente zyrtare ka një rëndësi të madhe për një shoqëri e cila synon të jetë demokratike.

Duke parë të metat e shumta të Ligjit ekzistues Qeveria e Kosovës ka filluar hartimin e një ligji tjetër për Qasje në Dokumente Publike. Lëvizja FOL ka qenë e pjesëmarrëse në grupin punues qeveritar për shqyrtimin e projektligjit për qasje në dokumente publike. Takimet e këtij grupi punues ende vazhdojnë dhe Lëvizja FOL ka paraqitur vërejtjet dhe rekomandimet e saj në mënyrë që ky Ligj të jetë sa i qartë dhe të lehtësoj qasjen në dokumente zyrtare. Mirëpo deri në miratimin e këtij Ligji vazhdon të jetë në fuqi ende ligji aktual.

Udhëzimi Administrativ nr.7/2008 –MAP për “Forcimin e Transparencës dhe Standardizimit të Faqeve të Internetit në Institucionet e Republikës së Kosovës”.

Duke u bazuar në këtë udhëzim Administrativ, të gjitha Institucionet e Republikës së Kosovës, të nivelit qendror dhe lokal, janë të obliguara të krijojnë, brenda periudhës gjashtëmujore, pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi administrativ, faqet e tyre në internet ose të përmirësojnë faqet ekzistuese në internet, për rritjen e transparencës, sipas standardeve të përcaktuara më këtë udhëzim administrativ.

Me këtë udhëzimin administrativ është caktuar se çka duhet të përmbajnë ueb-faqet e institucioneve, në mënyrë të detyrueshme. 2

Udhëzim Administrativ Nr. 2006/03 “Për transparencën në komuna”

Me qëllim të forcimit të transparencës së organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative komunale, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivelin lokal dhe lehtësimin e qasjes së publikut mbi dokumentet zyrtare të komunave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka hartuar Udhëzimin Administrativ Nr. 2006/03 “Për transparencën në komuna”. Ky udhëzim administrativ i përkujton edhe njëherë organeve komunale obligimet e tyre që kanë ndaj qytetarëve sa i përket qasjes në dokumentet zyrtare. Po ashtu rekomandon komunitat që të bëjnë një plan për transparencë në mënyrë që të përmirësojnë qasjen e publikut dhe transparencën në komuna. 3

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040

Neni 68 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale flet për informimin publik dhe konsultimi. Çdo komunë mban periodikisht, së paku dy herë në vit, takime publike në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë. Ndër të tjera ky Ligj obligon Kuvendet komunale miraton rregulloren komunale që promovon transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës.

Përmbledhje ekzekutive

Të gjitha Komunitat përveç Mitrovicës kanë rregullore komunale për transparencë që përbën një akt të vullnetit të mirë politik megjithëse zbatimi i rregullores është i mangët.

Të dhënat tregojnë se numri kërkesave për qasje në dokumente zyrtare në shtatë komunitat përkatëse arrin gjithsej në 27 për vitin 2009. Vetëm në komunën e Mitrovicës kanë qenë 22 kërkesa, të cilat thuhet se kanë marrë përgjigje pozitive. Ndërkaq, komunitat si Lipjani, Malisheva e Klina gjatë tërë vitit 2009 nuk kanë pasur asnjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare. Në Kamenicë e Vushtrri ka pasur vetëm nga një kërkesë ndërkaq në Podujevë kanë qenë vetëm dy kërkesa.

Ky rezultat është shumë shqetësues dhe dëshmon për një indiferencë të qytetarëve karshi institucioneve publike lokale sa i përket kërkesave për qasje në dokumente zyrtare. Kjo mund të jetë edhe si pasojë e nivelit të ulët të besueshmërisë së qytetarëve në institucionet publike. Mos funksionimi i ueb sajteve në nivelin e dëshiruar nga disa komuna të Kosovës bën që edhe ata qytetarë që si mjet për informim e përdorin internetin të mos arrijnë në informata të caktuara.

² <http://www.ks-gov.net/map/Document.aspx>

³ Udhëzim Administrativ Nr. 2006/03 “Për transparencën në komuna”, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Rekomandime

1. Komunat duhet ti përgatisin dhe publikojnë raporte vjetore për kërkesat për qasje në dokumente zyrtare.
2. Duhet të dihet më saktë numri i kërkesave që janë paraqitur për qasje në dokumente zyrtare, përgjigjet e dhëna si dhe arsyet e refuzimit të kërkesave eventuale Komunat duhet të mirëmbajnë dhe krijojnë regjistrat e dokumenteve zyrtare që janë në dispozicion të qytetarëve mbi bazën e kërkesës.
3. Komunat duhet ti njoftojnë qytetarët për dokumentet të cilat mund ti gjejnë në ueb faqen e Komunës.
4. Shumica e Komunave të përfshira në këtë raport kanë të miratuar rregulloren komunale për transparencë e cila cakton këto përgjegjësi vis-a-vis rritjes së transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare:
 - Mbledhjet e Kuvendit Komunal dhe komiteteve të tij janë të hapura për publikun dhe përfaqësuesit e mjeteve të informimit
 - Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës dhe komiteteve e tij do të publikohen në Ueb faqen e Komunës, në Gazetën e Komunës dhe në Tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës
 - Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës dhe komitetet e tij , sipas kërkesës janë në dispozicion të publikut
 - Gjatë vitit , në Sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës do të organizohen së paku dy tubime me publikun
 - Çdo person ose organizatë e interesuar ka të drejtë të parashtojë kërkesë për informacion për veprimtarinë e Komunës
 - Do të ndërmerren masat që të organizohet konsultimi publik në procedurën e miratimit të rregulloreve dhe akteve nga kompetenca e Komunës
 - T'i dorëzojë publikut informimin mbi të gjitha veprimet financiare publike në takimin e parë publik me qytetarë
 - Do të bëhet publikimi i tenderëve komunal në faqen e internetit të Komunës
 - Grupeve të shoqërisë civile do tu mundësohet të marrin pjesë dhe të monitorojnë procedurën e hapjes së tenderëve dhe të vëzhgojnë procesin dhe korrektësinë në zgjedhjen e ofertuesve
 - Në Faqen e Komunës do të vendosen të gjithë formularët që janë të nevojshëm qytetarëve për të aplikuar në lidhje me realizimin e të drejtave të ndryshme në organet komunale të administratës
 - Komuna do të njoftojë qytetarët në faqen e internetit të Komunës ,përmes informatorit të Komunës,dhe shpalljeve publike në Tabelën e shpalljeve dhe në vendet më të frekuentuara në vendbanimet e Komunës për të drejtën dhe procedurat për qasje në dokumentet zyrtare të Komunës

Konkluzione:

1. Lëvizja FOL nuk ka qenë në gjendje të verifikoi nëse obligimet e lartshënuara përmbushen nga Komunitat përkatëse megjithëse nga vëzhgimi i ueb faqeve të tyre përveç publikimit të lajmeve pjesët tjera të ueb faqeve të komunave nuk freskohen me kohë. Prandaj shprehim dyshim e bazuar se shumica e përgjegjësive të lartshënuara që kanë të bëjnë me ueb faqen zyrtare nuk zbatohen si p.sh. Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës dhe komiteteve e tij duhet të publikohen në Ueb faqen e Komunës.
2. Disa komuna megjithatë në ueb faqen e tyre kanë vendosur formularët që janë të nevojshëm për të aplikuar në lidhje me realizimin e të drejtave të ndryshme në organet komunale të administratës. Gjithashtu mbledhjet e Kuvendeve Komunale janë të hapura për medie dhe qytetar megjithëse nuk ka ndonjë interesim të madh të qytetarëve për pjesëmarrje në këto mbledhje.
3. Sa i përket takimeve publike të Komunave me qytetar nuk kemi mundur të gjejmë në ueb faqet e komunave informacion përkitazi për këto takime të cilat përbëjnë një aktivitetet të rëndësishëm të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Mungon informacion edhe sa i përket konsultimeve që komunat realizojnë me qytetar për draft-rregullore ose vendime të tjera që Komuna duhet të nxjerr.
4. Mbi të gjitha mungon transparencja e informacioneve financiare, përkatësisht qasja në kontratat publike dhe monitorimit i procesit vendimmarrës në dhënien e tenderëve. Megjithëse shumica e komunave marrin obligim nga rregullorja për transparencë që ti ftojnë shoqërinë civile të jetë pjesëmarrëse në hapjen e ofertave dhe vlerësimin e tyre lëvizja FOL nuk ka arritur të verifikoj nëse në 7 komunat e përfshira në këtë raport një gjë e tillë është respektuar.

Të gjeturat për komuna:

Komuna e Vushtrrisë

Kjo komunë ka hartuar Rregulloren Komunale për Transparencë, e cila cakton përgjegjësi praktike të institucionit të Komunës në zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike e cila rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjen e kuvendit të komunës dhe komiteteve të tij, mbledhjet e publikut, obligimin për njoftim e publikut, konsultimi i akteve komunale dhe pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në dokumente zyrtare të komunës.

Ndonëse e obliguar sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike , Komuna e Vushtrrisë asnjëherë nuk ka publikuar raporte vjetore sa i përket qasjes në dokumente zyrtare, ku do të duhej të përfshinte numrin e rasteve, të cilat komuna u ka refuzuar qasjen, arsyet për refuzimin si dhe numrin e dokumenteve të ndjeshme që nuk janë përfshirë në

regjistër. Komuna e Vushtrrisë gjithashtu nuk ka përgatitur regjistrin e dokumenteve sipas nenit 10 të Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare.

Neni 13 i Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare parasheh që Institucionet Publike të ndërmarrin masa të caktuara për të informuar qytetarët lidhur me të drejtën që gëzojnë sipas këtij ligji, mirëpo as ky nen nuk është respektuar nga Komuna e Vushtrrisë. Përveç disa posterëve të cilat janë sjellë në Komunë nga organet qendrore të Qeverisë në objektin komunal, Komuna si institucion nuk ka ndërmarr asnjë iniciativë për të njoftuar qytetarët për të drejtën e tyre për qasje në dokumente zyrtare. Madje edhe njohurit e zyrtarëve administrativ të Komunës për këtë Ligj janë të mangëta.

Ueb sajt zyrtar i kësaj komune me muaj të tërë është jashtë funksionit, kjo me arsyetimin se janë duke e bërë dizajnin e ri. 4 Ndërkaq, sa i përket numrit të kërkesave për qasje në dokumente zyrtare gjatë tërë vitit 2009 në këtë komunë është bërë vetëm një kërkesë, dhe ajo nga një këshilltar i kuvendit komunal, të cilit edhe i është mundësuar qasja në dokumente zyrtare.

Komuna e Kamenicës

Edhe në komunën e Kamenicës niveli i implementimit të ligjit është tejet i dobët. Sipas të dhënave të zyrtarëve komunal kjo komunë nuk ka publikuar asnjëherë raport vjetor me të dhënat statistikore për qasje në dokumente zyrtare. Në të njëjtën kohë kjo komunë ende nuk ka krijuar edhe regjistrat e dokumenteve ashtu siç parashihet me Ligj. Komuna e Kamenicës ka hartuar rregulloren për transparencë e cila edhe është aprovuar nga Kuvendi Komunal.

Komuna nuk ka ndërmarrë asnjë iniciativë për të njoftuar qytetarët me të drejtat e tyre që i gëzojnë sipas ligjit. Një mënyrë tjetër për qytetarët që të kenë qasje në dokumente zyrtare është edhe ueb sajt i komunës. Ndonëse thuhet se është funksional, informatat e postuara në këtë ueb sajt kanë të bëjnë kryesisht me aktivitetet e Kryetarit të Komunës ose zyrtarëve të lartë, nënkryetarit apo kryesuesit. Ka fare pak informata rreth punës së drejtorive ose sektorëve tjerë komunal.⁵

Ndërkaq, numri i kërkesave që janë paraqitur në Zyrën e pranimit për qasje në dokumente zyrtare ka qenë shumë i vogël. Gjatë tërë vitit 2009 thuhet se ka pasur dy kërkesa. Një kërkesë për një vendim, të cilës nuk i është dhënë përgjigje me arsyetimin se ka qenë dokument jo publik duke rënë ndeshë kështu me obligimin sipas rregullores për bërjen publike të vendimeve të organeve komunale. Ndërkohë, thuhet se ka pasur edhe kërkesa të tjera që janë bërë vetëm gojarisht kryesisht nga studentët, të cilët thuhet se kanë marrë përgjigje pozitive. Ndërsa kërkesa e dytë thuhet se nuk ka marrë përgjigje as pozitive e as negative, arsyet e mos përgjigjes thuhet se janë të panjohura.

⁴ <http://www.komuna-vushtrri.org/al/history/>

⁵ <http://kk.rks-gov.net/kamenice/Home.aspx>

Komuna e Klinës

Sipas zyrtarëve Komuna e Klinës gjatë vitit 2009 nuk ka pranuar asnjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare. Kjo komunë asnjëherë nuk ka publikuar një raport vjetor me të dhënat për kërkesat për qasje në dokumente zyrtare. Për dallim me komunat e tjera zyrtarët e Komunës së Klinës kanë deklaruar se kanë hartuar regjistrat e dokumenteve siç parashihet me nenin 10 të Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare. Komuna e Klinës ka miratuar rregulloren për transparencë e cila nuk është e publikuar në ueb faqen e komunës.

Komuna e Klinës informimin e qytetarëve për Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare e ka bërë gjatë takimeve publike, ku sipas të dhënave të FOL-it, në këto takime qytetarëve u është folur edhe për këtë ligj.

Komuna e Malishevës

Komuna e Malishevës është një shembull i mirë sa i përket implementimit të Ligjit për qasje në dokumente zyrtare. Kjo komunë përveç se bën raport vjetor siç parashihet me Ligj, sipas të dhënave që zyrtarët komunal i kanë dhënë bashkëpunëtorit të Lëvizjes FOL, kjo Komunë harton edhe raport gjashtëmujor. Malisheva po ashtu ka krijuar edhe regjistrat e dokumenteve siç kërkohet me nenin 10 të Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, dhe këto regjistra janë në Zyrën e Pritjes dhe Arkiv.

Ndërkaq Rregullorja për Transparencë, është në procedurë të hartimit dhe miratimit sipas procedurave ligjore. Ndërsa në mungesë të kësaj rregulloreje kjo komunë sipas zyrtarëve komunal e shfrytëzon një Udhëzim Administrativ deri në miratimin e rregullores.

Komuna e Malishevës duket se ka përdorur mënyra të ndryshme për informimin e qytetarëve lidhur me këtë Ligj. Për këtë gjë komuna ka aplikuar forma të ndryshme të informimit si fletushka, radioemisione, takime publike, ku përmes këtyre formave qytetarët janë informuar për të drejtat e tyre. Ndërkaq, sipas të dhënave nga ueb sajt kryetari i kësaj komune pret qytetarët për dy orë në zyrën e tij çdo të enjte⁶.

Ueb sajt i kësaj komune është funksional që nga viti 2004 dhe freskohet vazhdimisht sipas nevojës. Mirëpo përkundër të gjitha këtyre masave që kjo komunë ka ndërmarrë për implementimin e këtij ligji në mënyrë sa më të mirë, qytetarët e kësaj komune duken të pa interesuar për të bërë kërkesa për qasje në dokumente zyrtare. Gjatë tërë vitit 2009 kjo komunë nuk ka pranuar asnjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, të dhëna këto të cilat i kanë prezantuar zyrtarët komunal.

⁶ <http://www.malisheva-komuna.org/index.php>

Komuna e Mitrovicës

Komuna e Mitrovicës është përgjigjur në të gjitha kërkesat që ka pranuar për qasje në dokumente publike dhe kjo i jep notë pozitive kësaj komune në këtë aspekt. Mirëpo Komuna e Mitrovicës nuk ka publikuar raporte vjetore rreth qasjes në dokumente zyrtare, siç parashihet me nenin 16 në Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare si dhe ende nuk ka krijuar regjistrat e dokumenteve, siç parashihet me nenin 10 në Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare. Kësaj komune po ashtu i mungon edhe rregullorja komunale për transparencë. Sipas të dhënave që FOL posedon në pushtetin e kaluar në këtë komunë ishte aprovuar një plan për transparencë i cili ishte postuar edhe në ueb sajt të komunës mirëpo tani nuk është më aty.

Komuna e Mitrovicës është treguar neglizhente sa i përket përmbushjes së obligimit për të informuar qytetarët me të drejtat e tyre për qasje në dokumente të komunës. Madje edhe ueb sajt zyrtar nuk është funksional në nivelin e dëshiruar.⁷

Ndërkaq, numri i kërkesave për qasje në dokumente në këtë komunë është më i larti nga komuna që FOL ka monitoruar. Gjatë vitit 2009 janë paraqitur 22 kërkesa për qasje në dokumente zyrtare: 9 nga këto kërkesa thuhet të kenë qenë për Drejtorin për Buxhet dhe Financa, 4 për Kuvendin Komunal, 1 për Administratë, 1 për Drejtorin për Mbrojtje dhe Shpëtim, ndërkaq kërkesat tjerat kanë qenë për zyrën e Kryetarit dhe Nënkyetarit. Komuna është përgjigjur në të gjitha kërkesat.

Komuna e Podujevës

Komuna Podujevës hyn në listën e vogël të komunave të cilat kanë publikuar raport vjetor sa i përket qasjes në dokumente zyrtare në përputhje me nenin 16 të Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare. Në kuadër të këtij raporti përfshihen të dhënat e kërkesave të qytetarëve për qasje në dokumentet zyrtare, si dhe përgjigjja e organeve kompetente lidhur me këto raste. Mirëpo zyrtarët komunal nuk kanë qenë të gatshëm që këtë raport t'ia ofrojnë edhe FOL-it.

Përveç raportit vjetor kjo komunë ka hartuar edhe regjistrin e dokumenteve. Ndërkohë rregullorja për transparencë ende është në procedurën e miratimit. Komuna e Podujevës nuk ka realizuar aktivitetet vetëdijësuese për ti njoftuar qytetarët për të drejtat e tyre sa i përket qasjes në dokumente zyrtare. Sipas të dhënave që na janë ofruar nga zyrtarët komunal, ata mendojnë se qytetarët do të kenë rast të informohen për të drejtën ligjore të tyre për qasje në dokumentet zyrtare në një debat publik që do të realizohet për propozim-rregulloren për transparencë. Kjo komunë para përgatitjes së kësaj propozim-rregulloreje në Kuvend, ka miratuar Planin për Transparencë të institucioneve të Kosovës. Edhe ueb sajt i kësaj komune është funksional i cili freskohet vazhdimisht me informata të reja.⁸

⁷ <http://www.mitrovica-komuna.org/>

⁸ <http://www.podujeva-komuna.org/>

Ndërkaq sa i përket numrit të kërkesave për qasje në dokumente zyrtare, gjatë vitit 2009, në këtë komunë kanë qenë vetëm dy kërkesa, të cilat kanë marrë përgjigje nga komuna. Në kërkesën e parë thuhet se qytetari ka pasur qasje të plotë në dokumentin e kërkuar, ndërsa në rastin e dytë qytetari ka pasur qasje të pjesshme për shkak të ndjeshmërisë të dokumentit të kërkuar.

Komuna e Lipjanit

Komuna e Lipjanit ka publikuar në Mars të vitit 2010 raportin vjetor të Komunës sa i përket Qasjes në Dokumente Zyrtare siç kërkohet me nenin 16 të Ligjit përkatës. Megjithëse Komuna e Lipjanit publikon raporte vjetore, ajo ende nuk i ka krijuar regjistrat e dokumenteve, siç parashihet me nenin 10 të Ligjit përkatës.

Komuna e Lipjanit ka miratuar edhe rregulloren për transparencë, me qëllim të implementimit në praktikë të dispozitave të cilat përcaktojnë obligimet e Komunës për transparencë. Aktivitetet e vetme të kësaj komune për të informuar qytetarët për Ligjin për qasje në dokumente Zyrtare dhe të drejtat që iu garanton ky ligj kanë qenë diskutime në tryeza të ndryshme dhe publikimi i rregullores në ueb sajt zyrtar të komunës. Në këtë komunë numri i kërkesave për qasje në dokumente zyrtare gjatë vitit 2009 ka qenë zero.

Raportet e publikuara nga OSBE dhe YIHR gjatë viti 2007

Sipas një raporti mbi implementimin e Ligjit për Qasje në Dokumentet Zyrtare në nivel Komunal të publikuar nga OSBE në nëntor të vitit 2007, një problem shumë i madh duket të jetë njohuria e komunave lidhur me kornizën ligjore.

Edhe pse shumica e komunave kanë qenë në dijeni për ekzistimin e Ligjit për qasje në dokumente zyrtare, zyrtarëve komunal duket se ju kanë munguar njohuri të qarta të ligjit primar dhe akteve nënligjore të lëshuara nga ministritë përkatëse dhe qeveria gjatë procesit të implementimit të Ligjit⁹. Për fat të keq edhe dy vjet pas këtij raporti, implementimi i këtij ligji vazhdon të jetë nën nivelin e dëshiruar, kjo bazuar në të dhënave që Lëvizja FOL i posedon.

⁹ OSBE- Raporti mbi implementimin e Ligjit për Qasje në Dokumentet Zyrtare në nivel Komunal, Nëntor 2007

Tabela vijuese jep një pasqyrë të informatave të pranuar nga zyrtarët komunal, sipas raportit të OSBE të vitit 2007, për komunat të cilat edhe FOL i ka monitoruar.

	Numri i kërkesave të pranuar	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar
Mitrovicë	6	6	0
Vushtrri	1	1	0
Podujevë	0	0	0
Lipjan	3	3	0
Klinë	6	6	0
Malishevë	0	0	0
Kamenicë	13(2 në procedurë)	11	0

Po në vitin 2007 edhe Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut(YIHR) ka publikuar një raport me statistika për qasje në dokumentet zyrtare nga të gjitha komunat e Kosovës. Sipas këtij raporti nga 30 komunat e Kosovës, 13 prej tyre nuk janë përgjigjur në asnjë kërkesë që i është bërë, ku në mesin e tyre hyjnë edhe komuna e Podujevës dhe komuna e Lipjanit. Në tabelën vijuese pasqyrohet numri i kërkesave të dërguara komunave përkatëse, po ashtu shihet edhe numri i përgjigjeve të marra dhe përqindja e respektimit të Ligjit, gjithmonë duke iu referuar raportit të vitit 2007. 10

	Numri i kërkesave	Numri i përgjigjeve	Përqindja %
Mitrovicë	15	3	20
Vushtrri	15	1	6.66
Podujevë	15	0	0
Lipjan	15	0	0
Klinë	15	2	13.33
Malishevë	16	1	6.25
Kamenicë	16	2	12.50

###

¹⁰ Raport - Monitorimi Ligjit për Qasje në Dokumentet Zyrtare, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Janar 2007